VENDIM
Nr.45, datë 28.5.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË "FAVINA 1" SHPK ME SERI PV05V, NR.29, LËSHUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR.85, DATË 27.12.2005

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nenit 10, pika "3" dhe nenit 15 të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, dhe nenit 18 pika 1, germa "a", të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009 të Bordit të Komisionerëve, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.5.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë "Favina 1"sh.p.k., për ndryshimin e licencës nr.29, seria PV05P, për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005 dhe informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit siç kërkohet nga "Rregullorja për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave",

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e licencës nr.29, seria PV05P, të shoqërisë 'Favina 1" sh.p.k., për kryerjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.85, datë 27.12.2005.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta